



PRISHTINA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.

DOSJA E TENDERIT

Sipas Nenit 27 të Ligjit Nr. 04/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 s

“PROCEDURA E KUOTIMIT TË ÇMIMIT”

PUNË

FURNIZIM

SHËRBIME

Data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit : **09.03.2021**

Nr. i Prokurimit ¹	NPL.ST.AUT-21-1118-2-3-6
Nr i brendshëm	SAP-21-006-236

Titulli: **SHËRBIME PËR VLERËSIMIN E KËNAQSHMËRISË SË KONSUMATORIT**

KJO DOSJE E TENDERIT PERBEHET PREJ TRI PJESËVE :

Pjesa A: Informacione për Tenderuesit;

Pjesa B: Draft Kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranojë tenderuesi që merr kontratën; dhe

Pjesa C: Formulari i Kuotimit.

Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhët Shqipe dhe Serbe.

Ne rast se ka mospërputhje ne mes versioneve gjuhësore, versioni i gjuhës *Shqipe* do te mbizotëron.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

LËNDA: FTESË PËR KUOTIMI TË ÇMIMIT për SHËRBIME PËR VLERËSIMIN E KËNAQSHMËRISË SË KONSUMATORIT

Ju faleminderit për interesimin e juaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartë përmendur të prokurimit.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit

Nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët dhe seksionet e kësaj dosje të tenderit dhe anekset e saj dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Ne, si Autoritet Kontraktues nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Në rast të dështimit të dorëzimit të tenderin tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen e Tenderit, dhe/apo nuk është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, tenderi i juaj do të refuzohet dhe do të konsiderohet si “ *tender i papërgjegjshëm*”

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e tenderit duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura.

Kjo procedure e tenderimit është e rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publik (nr. i Ligjit 04/L-042 *për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*) dhe rregullave të prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.

LPP-ja dhe Rregullat e Prokurimit mund të shkarkohen nga web-faqja e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP): www.krpp.rks-gov.net.

Kuotimi i çmimit duhet të dorëzohet në adresën e specifikuar në pjesën A “Procedurat e Tenderimit” para

17.03.2021 në **14:00:00** orë

Me dorëzimin e tenderit, tenderuesi pranon në mënyrë të plotë dhe pa rezerva kushtet që rregullojnë këtë kontratë të propozuar si një bazë të vetme të kësaj procedure të tenderimit.

Mirëpresim pranimin e Kuotimit tuaj.

Nëse vendosni të mos e dorëzoni çmimin e kuotimit, do të ishim mirënjohës nëse do të na lajmëronit me shkrim, duke cekur arsyet e vendimit të juaj.

Me sinqeritet,

Emri dhe Mbiemri: **Fitim Vokrri**

Nënshkrimi: _____

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA A:	INFORMACIONE PËR TENDERUESIT.....	1
NENI I	IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES.....	1
NENI II	QËLLIMI I KONTRATËS.....	2
NENI III	KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK.....	3
NENI IV	INFORMACIONE SHITESË.....	6
IV.1	AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE ...	6
IV.2	AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E KUOTIMEVE TË ÇMIMIT.....	6
IV.3	HAPJA E KUOTIMEVE:.....	6
IV.4	FORMULARI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT dhe LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA.....	7
IV.5	PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT.....	7
IV.6	KRITERET PËR DHËNIE TË KONTRATËS.....	7
IV.7	VLERËSIMI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT.....	7
NENI V	ANKESAT.....	9
Aneksi 1.	SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.....	10
Aneksi 2.	DEKLARATA NËN BETIM.....	13
Aneksi 3.	KËRKESË PËR INFORMACIONE SHITESË.....	14
Aneksi 4.	KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS.....	15
PJESA B:	DRAFT KONTRATA.....	17
PJESA C:	FORMULARI I PARAQITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT.....	21
Seksioni I.	Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT.....	21
Seksioni II.	Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT.....	22

PJESA A: INFORMACIONE PËR TENDERUESIT

Në tërë këtë dosje të tenderit ju referoheni si "Operatori Ekonomik" ose "Tenderuesi".

Lëshuesi i kësaj dosjeje të tenderit është referuar si "Autoriteti Kontraktues".

Ju duhet të kuotoni **të gjithë artikujt** e specifikuar në këtë Dosje të Tenderit. Ju duhet të ofroni një çmim fiks **të shumës së plotë në Euro**, duke përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet e zbatueshme si dhe çdo pagesë tjetër apo të taksë të transportit, sigurimit, instalimit, detyrime apo taksa të tjera.

Kuotimi i çmimeve do të vlerësohet për të gjithë artikujt së bashku dhe kontrata do t'i ipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin më të mirë në përputhje me kriteret për dhënie e kontratës të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

NENI I IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

I.1 EMRI ZYRTAR DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK:	STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.		
Adresa e AK:	BILL CLINTON		
Adresa elektronike:	www.sap-rks.com	Kodi postar i qytetit të AK:	PRISHTINË 10000
Personi kontaktues:	FITIM VOKRRI	E-mail:	prokurimi@sap-rks.com
Telefoni	038/551 333 044/150 606	Faksi:	

(Kuotimi i çmimit duhet të dorëzohet në adresën e autoritetit kontraktues si më lart.)

NENI II QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës: SHËRBIME PËR VLERËSIMIN E KËNAQSHMËRISË SË KONSUMATORIT

II.2 Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 73000000-2

II.3 Qëllimi i kësaj kontrate është [dërgesa], [instalimi], [mirëmbajtja], dhe [shërbimi pas-shitjes] nga operatori ekonomik *punët* *furnizimet* *shërbimet* si në vijim:

SHËRBIME PËR VLERËSIMIN E KËNAQSHMËRISË SË KONSUMATORIT

II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike - punët *furnizimet* *shërbimet* duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1.

II.5 Vendi për “[dërgimin e furnizimeve]” “[kryerjen e shërbimeve]” “[ekzekutimin e punëve]” është **NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A-Prishtinë**

II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: në muaj ose në ditë 20 ose

fillim përfundim

II.7 Kërkesat e garantimit:

NENI III KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK

Operatorët ekonomik duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim. Çdo mos përmbushje e ndonjëres nga kërkesat do të eliminojë tenderin e tyre nga konkurrimi.

III.1 KËRKESAT E PËRSHTATSHMËRISË

1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij/saj:

- a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues;
- b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të këtyre të fundit;ose
- c. duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 4 paragrafi 1.75.

2. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë (10) viteve të fundit:

- a. është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
- b. është deklaruar i papërshtatshëm kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rende profesionale e konstatuar nga një gjykatë kompetente;
- c. është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale serioze të pjesëmarrjes në aktivitetet e një organizate kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme në vendin ku ndodhin ato;
- d. është shpallur fajtor për mashtrim apo një akt të ngjashëm me mashtrim nga një gjykatë kompetente;
- e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
- f. është konstatuar nga një gjykatë kompetente se ka bërë keqinterpretime para autoriteteve publike në Kosovë ose diku tjetër.

3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operator ekonomik:

- a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimit të urdhrin për likuidim ose përmbyllje të

aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër:

- b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
- c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafte që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
- d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët a, b, ose c të këtij paragrafi, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
- e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga ose për një operatori të tillë ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.
- f. aktualisht është lëndë e një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon ose redukton pagesat nga ose për operatorët e tillë ekonomik nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
- g. gjatë tri (3) viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë njësi publike, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë ose diku tjetër;
- h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar te jete jo i rëndësishëm në Kosovë;
- i. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
- j. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës;
- k. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes;ose
- l. nuk është shpallu fajtor me një vendim të plotfuqishëm të miratuar r në përputhshmëri me Nenin 99.2 të LPP-se.

Dëshmi të dokumentuara për kërkesat e përshtatshmërisë:

- a. një deklaratë me shkrim nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.
- b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit për fituesin [para datës së publikimit të Njoftimit për dhënje të Kontratës]
- c. Vërtetim nga Gjykata Ekonomike

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- a)** Deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
- b)** Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit për fituesin [para datës së publikimit të Njoftimit për dhëje të Kontratës] për fituesin e tenderit
- c)** Vërtetim nga Gjykata Ekonomike-Origjinal për fituesin e tenderit

<p>III.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale</p>	<p>Përshtatshmëria profesionale</p> <p>Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm, duhet t'i dorëzojë Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik</p> <p>a)Çertifikata e regjistrimit te biznesit b) Certifikata e TVSH-së c) Certifikata me numër fiskal (te lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a)Kopja e certifikates se regjistrimit te biznesit b)Certifikata e TVSH-së. c) Certifikata me numer fiskal (te lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës</p>
<p>III.3 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</p>	<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p>
<p>III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p>	<p>Kapaciteti teknik dhe professional</p> <p>Kapaciteti teknik dhe professional Kompania duhet të ketë së paku 5(pesë)vite përvojë në lëminë që duhet të angazhohet</p> <p>a. Operatori ekonomik duhet që të ketë përfunduar së paku dy kontrata për lëminë e kësaj natyre të shoqeruara me referencë - çertifikata per periudhen 36 mujore para Njoftimit per Publikim te Kontrates</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshminë mbi angazhimin kredibilë a .Nji listë të shërbimeve të realizuara e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik per periudhen 36 mujore para njoftimit per publikim të kontratës.- Duke saktësuar Shumen e kontratave,daten dhe pranuesin si dhe referencat- çertifikatat per shërbimet e realizuara.</p>

NENI IV INFORMACIONE SHITESË

IV.1 AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE

Operatorëve ekonomik u lejohej të bëjnë **kërkesë me shkrim**, për të kërkuar nga autoriteti kontraktues informata sqaruese ose shtesë që mendojnë se janë të nevojshme për përgatitjen dhe për dorëzimin e Kuotimit të Çmimit të përgjegjshëm. Një kërkesë e tillë duhet të pranohet nga autoriteti kontraktues, jo më vonë se: **15.03.2021**

Një kërkesë e tillë mund të bëhet me anë të përdorimit të formularit të kërkesës, Aneksi 3, dhe t'i dorëzohet autoritetit kontraktues në mënyrë elektronike, me shkrim ose me faks. Çdo sqarim i dosjes së tenderit do të komunikohet njëkohësisht me shkrim të gjithë ofertuesve.

IV.2 AFATI KOHOR DHE VENDI PËR DORËZIMIN E KUOTIMEVE TË ÇMIMIT

Kuotimet e çmimeve do të pranohen nga autoriteti kontraktues më së voni me:

Data: 17.03.2021 **Koha:** 14:00:00 **Vendi:** **NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A-Prishtinë**

Operatorët ekonomik mund t'i dorëzojnë vetëm një kuotim të çmimit dhe nuk mund të bëjnë asnjë ndryshim në kuotimin e çmimeve të dorëzuara.

IV.3 HAPJA E KUOTIMEVE:

Autoriteti Kontraktues do të bëjë hapjen e kuotimeve në publik me:

Data: 17.03.2021 **Koha:** 14:00:00 **Vendi:** **NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A-Prishtinë**

Çdo tenderues ka të drejtë të ketë përfaqësuesin prezent që të vrojtoj hapjen e tenderëve.

Të gjitha ofertat do të hapen në një kohë, duke lexuar me zë: emrin dhe adresën e tenderuesit, Çmimin total të kuotimit të specifikuar në formularin e dorëzimit të Kuotimit dhe, kurdo që është e mundur, çmimet për njësi. Kur për arsye të jo atypëratyshme çmimet për njësi nuk mund të lexon, çmimet e tilla në çdo rast duhet të bëhen të dukshme gjatë hapjes publike për të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, si për shembull duke bere postimin e tyre ose duke përdorur ndonjë tjetër metode adekuate e cila garanton transparencën. Në çdo rast, secila faqe e çdo tenderi financiar do të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një ofertuesi tjetër. Në rast të aktivitetit të prokurimit ku kriteri i shpërblimit të kontratës është tenderi ekonomikisht më i favorshëm çdo gjë që ka të bëjë me numra duhet të lexohet si afati i dërgesës, periudha e garancionit etj. E gjithë kjo duhet të regjistrohen në procesverbalin e hapjes së tenderëve, i cili duhet të nënshkruhet nga Zyrtari i Prokurimit dhe nga të gjithë

pjesëmarrësit në procesin e hapjes së tenderit. Kopjet e procesverbalit në fjalë, duhet tu dërgohen menjëherë të gjithë tenderuesve.

IV.4 FORMULARI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT dhe LISTA E DOKUMENTEVE TË KËRKUARA

Kuotimi i Çmimit do të përmbaj si në vijim:

- a) **Formularin e kuotimit të çmimit;**
- b) **Formulari i përshkrimit të çmimit;**
- c) **Deklaratën nën Betim te nënshkruar, Aneksi 2; dhe**
- d) **Çdo dokument tjetër të kërkuar sipas nenit III.2, III.3 dhe III.4 të kësaj Dosjeje të Tenderit.**

IV.5 PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Kuotimi i çmimeve do të jetë i vlefshëm për **45** ditë nga afati i dorëzimit të kuotimeve të çmimit.

Operatori ekonomik nuk mund ta tërheqë kuotimin e tij të çmimeve pas afatit për dorëzimin të kuotimeve të çmimeve dhe para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së kuotimit të çmimeve.

IV.6 KRITERET PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Kontrata do t'i ipet operatorit ekonomik që ka dorëzuar:

Tenderin e përgjegjshëm, me çmimin më të ulët **ose**

tenderin e përgjegjshme ekonomikisht më të favorshëm të përcaktuar në bazë të peshës së kritereve të përshkruara në Aneksin 4

IV.7 VLERËSIMI I KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Kuotimet e çmimit të pranuar me **kohë** do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas kërkesave të përcaktuara në këtë dosje të tenderit.

Një kuotim konsiderohet të jetë **përgjegjës** kur:

- a.përputhet në aspektin administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b.përputhet në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosjen e tenderit;
- c.është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.

Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e Kuotimeve të Çmimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht sqarim mbi Kuotimin e Çmimit të tij/saj. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk guxon të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim.

Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Gabimet e korrigjuara në këtë mënyrë do të jenë të obligueshme për tenderuesin. Autoriteti kontraktues menjëherë do të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

Kuotimet e Çmimeve të **përgjegjshme** do të vlerësohen dhe krahasohen sipas **kritereve për dhënien e kontratës** të përcaktuara në këtë dosje të tenderit. Operatori ekonomik i cili ka dorëzuar kuotimin e renditur më se larti sipas rezultatit, do të shpërblehet me kontrate.

NENI V ANKESAT

1 Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ankesa mund të dorëzohet, pa pagesë, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij

Forma standarde e ankesës mund të shkarkohet nga faqet e internetit të KRPP-së ose OSHP-së: www.krpp.rks-gov.net ose www.osh.rks-gov.net.

Ankesat duhet të dorëzohen në origjinal te Autoriteti Kontraktues, në adresën e specifikuar në **FDT**.

- Kurdo që ankesa ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.
- Kurdo që ankesa ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës që i është dërguar ankuesit.
- Kurdo që ankesa ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Të gjitha ankuesit duhet të paguajnë një tarifë për ankese në shumë prej (shëno shumën në €), së bashku me paraqitjen e një ankese në OSHP. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose të holla ekuivalente në llogarinë e krijuara nga OSHP-ja.

Referojuni LPP dhe Rregullave të Prokurimit për procedurat e ankimeve të mëtejshme.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Terma te references

Matja e kënaqshmërisë se konsumatorit

Prapavija

NPL “Stacioni i Autobuseve” sh.a. Prishtine, pas përfundimit të luftës, është administruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Në ndërkohë, në vitin 2015 është transformuar në ndërmarrje publike komunale, si shoqëri aksionare me Kuvendin Komunal (KK) të Prishtinës, si pronar të vetëm të ligjshëm të të gjitha aksioneve të ndërmarrjes. Në këtë kontekst, KK i Prishtinës ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e parapara me ligjet në fuqi, por edhe me Statut dhe akte të tjera nënligjore të ndërmarrjes.

Vizioni i ndërmarrjes është që në vazhdimësi të ofrojë shërbime sa më cilësore për publikun dhe klientët, por edhe të ketë një qëndrueshmëri financiare, ngase këto dy elemente janë qenësore për zhvillimin dhe modernizimin e mëtutjeshëm të Stacionit të Autobusëve – që krahas aeroportit të vendit, sigurisht se përfaqëson portën kryesore për hyrje në Kosovë, si për udhëtime brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Si rrjedhojë, NPL Stacioni i Autobusëve Sh. A. Prishtinë planifikon të mbetet një qendër e rëndësishme e ofrimit të shërbimeve për klientët e vetë të shumtë, qofshin ata vendorë ose ndërkombëtarë.

Prezantimi

Ndërmarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal. Burimet kryesore të hyrave janë shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave për operatorët e transportit, shërbimi i ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, shërbimi i parkingut, shërbimi i poligoneve për auto shkolla, qiradhënia e lokaleve afariste në pronësi të Stacionit.

Ndërmarrja ofron shërbime te ndryshme për operatorët e ndryshëm ekonomik te cilët e shfrytëzojnë NPL Stacioni i Autobusëve Sh. A. Prishtinë, për afarizëm te tyre. Prej tyre janë:

- 180 operatore transportues qe operojnë ne ndërmarrje, te cilët bëjnë lidhjen transportuese mes Prishtinës dhe qyteteve vendore dhe ndërkombëtare
- 56 auto shkolla te cilët I shfrytëzojnë hapësirat e ndërmarrjes për aftësimin e kandidatëve te ndryshëm,
- 29 lokale afariste janë te lëshuara me qira ku përmes aktiviteteve te ndryshme bizneset afarojne ne veprimtari hotelierë dhe shërbyese.
- 2 kompani te taksive te cilët operojnë nga stacioni I autobusëve

Qëllimi

Bazuar ne Ligjin mbi ndërmarrjet publike Ligji nr. 05/L-009, Bordi i ndërmarrjes një here ne vit do te masin kënaqësinë e konsumatorëve ne baze te procedurave përkatëse përmes organizatave kredibile te pavarura.

Vlerësimi i tille është shume me rëndësi sepse i ndihmon ndërmarrjes ne zhvillimin e objektivave strategjike për çdo vijues.

Pra kompania e përzgjedhur si një kompani e pavarur dhe kredibile do te beje këtë matje te kënaqësisë se konsumatorëve sipas metodologjisë me te mire e cila është ne dispozicion me qellim te gjetjes se informatave me te sakta ne baze te intervistimit te bere ndaj pranuesve te shërbimeve te ndërmarrjes.

Metodologjia

Kompania e përzgjedhur është e obliguar qe te beje:

- Përpilimin e pyetësorit qe ka për baze matjen e kënaqësisë se konsumatorëve
- Te përcaktoje mostrën përfaqësuese për intervistimin e pranuesve te shërbimit
- Te beje intervistimin e pranuesve te shërbimit përmes intervistimi direkt
- Te beje analizimin e te dhënave me ndonjë prej programeve- softuerëve i cili përdoret për analiza dhe vlerësime te këtij lloji
- Përgatitë raportin final dhe te dorëzoje deri me kohen e përcaktuar sipas këtyre termave te referencës.

Logjistika

Me rastin e lidhjes së kontratës, kompania e përzgjedhur do te këtë takim njoftues me përfaqësuesit e Ndërmarrjes,

Kompanisë se përzgjedhur do ti ofrohen te gjitha dokumentet relevante lidhur me vlerësimin e bere.

Kompania e përzgjedhur do te beje pyetësorin i cili do te përdoret për këtë vlerësim. Pyetësorët duhen te kenë pyetje te përgatitura te cilat do te masin kualitetin e shërbimeve ne mënyre sasiore dhe kualitative. Pra pyetësori duhet te këtë pyetje te kombinuare me qellim te arritjes se rezultatit te dëshiruar.

Ndërmarrja do të sigurojë të gjitha aranzhimet e nevojshme logjistike për ofruesin e shërbimeve. Përfaqësuesi i ndërmarrjes do të sigurojë hapësirë të mjaftueshme të punës për ofruesin e shërbimeve.

Kualifikimet e nevojshme te kompanisë se angazhuar

Kompania e përzgjedhur duhet te ketë përvojë se paku 5 vjeçare ne lëmine te cilën duhet te angazhohet. Duhet te ketë angazhime kredibile te cilat duhet te arsyetohen me prezantimin e portofolion e punëve te bëra ne 5 vitet e fundit.

Propozimi

Propozimi i kërkuar nga kompania e përzgjedhur duhet të ofroj detaje të mjaftueshme për ofruesin e shërbimeve ne këtë rast NPL Stacioni i Autobusëve Sh. A. Prishtinë.

Kompania duhet të prezantoje:

- Pyetësin e përgatitur për këtë angazhim,
- Mostrën përfaqësuese,
- Një plan të detajuar kohor për përfundimin e angazhimit
- Një sfond dhe pasqyrë të plotë të kompanisë:
- Konfirmimi e kompanisë se e kuptoni anën e logjistikës, sipas pikës 1.5
- Kopje të certifikatës së regjistrimit të biznesit tuaj;
- Detajet e 3 referencave që mund të kontaktohen në mënyrë që të ofrojnë dëshmi për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga kompania juaj;
- Përparësi do të kenë ato kompani të cilat kanë përvojë në përgatitjen e kësaj lloji vlerësimi

Ju lutem vini re se lehtësia e kuptimit dhe prezantimit të propozimit të juaj do të merret në konsideratë pas përfundimit të vlerësimeve.

NPL “Stacioni i Autobuseve” sh.a.Prihstine

Rr. Bill Clinton p.n.

10000 Prishtine

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Aneksi 3. KËRKESË PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: **STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.**

DUKE MARRË PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej “Operatori Ekonomik”), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit:

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identikuara.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
Adresa e plotë:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 4. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS²

[Elementet e mëposhtme për përcaktim të kritereve nuk janë të vetmet kritere dhe nuk janë obligative. Kriteret duhet të zgjedhën sipas nevojës së Autoritetit Kontraktues dhe lendes së kontratës.]

Kategoritë		Përshkrimi i kritereve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
1	Çmimi	Pikët <100x %> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	%	$P = \frac{P_s}{P_t} \times [100x\%]$
2	[Operimi, mirëmbajtja, dhe shpenzimet e tjera të përditshme]	[Pikët <100x %> për tenderin me shpenzimet më të mira operationale. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht (në shpenzime)]	%	$O = \frac{O_s}{O_t} \times [100x\%]$
3	[Karakteristikat funksionale, teknike, estetike, të mjedisit apo të ngjashme]	[Saktësoni]6 [Merr në konsideratë një (ose më shumë) nga karakteristika(t) objektive matëse dhe jepi pikët<100x %> për tenderin me karakteristika(t) më të mira. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht (me nota).]	%	$C = \frac{C_s}{C_t} \times [100x\%]$
4	[Shërbimet pas shitjes, ndihma teknike]	[Saktësoni]8 [Merr në konsideratë një ose (më shumë) nga karakteristika(t) matëse dhe jepi pikët <100x %> për tenderin me asistencë teknike më të mirë. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht (me nota)]	%	$S = \frac{S_s}{S_t} \times [100x\%]$
5	[Karakteristikat kualitative]	[Saktësoni]10 [Merr në konsideratë një ose (më shumë) nga karakteristika(t) objektive matëse dhe jepi pikët <100x %> për tenderin me karakteristika(t) më të mirë. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht (me nota)]	%	$Q = \frac{Q_s}{Q_t} \times [100x\%]$
			100 %	

Kriteri për tenderin ekonomikisht me te favorshëm

<input checked="" type="checkbox"/>	Çmimi më i ulët
	<i>ose</i>
<input type="checkbox"/>	Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të
<div style="border: 1px solid black; height: 40px; width: 100%;"></div>	

³Jo e aplikueshme, nëse kriteri për dhënien e kontratës është "çmimi më i ulët i tenderit të përgjegjshëm"

⁴Pesha e dhënë secilës nga kriteret (në % - totali i të gjitha peshave duhet të jetë i barabartë me 100)

⁵ku P- Pikët për tenderin, Ps= Çmimi më i ulët, Pt = çmimi i tenderit

⁶ku O- Pikët për tenderin, Os= Shpenzimet më të mira Operacionale, Ot = Shpenzimet Operacionale të Tenderit

⁷Nëse disa karakteristika merren në konsiderate, përshkruaj peshën dhe përcakto metodën e vlerësimit për secilën

⁸Ku C- Pikët për tenderin, Cs= Pikët për karakteristikat më të mira, Ct = pikët për karakteristikat e tenderit

⁹Mund të jetë numri i pikëve të shërbimit të shitjes në një regjion të specifikuar, ose numri i agjentëve, ose numri i teknikëve, etj...

¹⁰ku S- Pikët për tenderin, Ss= Notat më të mira të AT, St = notat e AT të tenderit

¹¹Nëse disa karakteristika merren në konsiderate, përshkruaj peshën dhe përcakto metodën e vlerësimit për secilën

¹²ku Q- Pikët për tenderin, Qs= Pikët për karakteristikat më të mira, Qt = pikët për karakteristikat e tenderit

PJESA B: Draft KONTRATA

STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A., (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

[shëno emrin e Operatorit Ekonomik] (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

SHËRBIME PËR VLERËSIMIN E KËNAQSHMËRISË SË KONSUMATORIT me numër Identifikues **NPL.ST.AUT-21-1118-2-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë [shëno përshkrimin e përgjithshëm të Kontratës, duke përfshirë sasi të].

1.2 Kontrata hynë në fuqi me [shëno datën] dhe përfundon me [shëno datën].

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [dërgimit të furnizimeve] [ekzekutimit të punëve] [kryerjes së shërbimeve] do të jetë [shëno vendin].

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP³ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

³ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: *[shëno çmimin total në shifra]* €; *[shëno çmimin total me shkrim]* Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[nëse kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[furnizimeve]* *[shërbimeve]* *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[furnizimeve]* *[shërbimeve]* *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *[Shqip]* *[Serbisht]* *[Anglisht]*⁴ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:		Emri:	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

⁴ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

PJESA C: FORMULARI I PARAQITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Për: **STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A.** (më tej “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i Kontratës: **SHËRBIME PËR VLERËSIMIN E KËNAQSHMËRISË SË KONSUMATORIT**

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr **NPL.ST.AUT-21-1118-2-3-6**. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Çmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Çmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: *[shëno çmimin e përgjithshëm në shifra €]*

Dhe me shkrim *[shëno çmimin e tenderit me shkrim Euro]*

3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej *[shëno numrin e ditëve]* nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësisht të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të financuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

DORËZUAR NGA:

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	
ADRESA E PLOTE	
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	
POZITA	

NENSHKRIMI	
DATA	
VULA	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP⁵ - €	Çmimi total €	Koha e dërgesës
1.						
2.						
3.						
etj						
Totali i Përgjithshëm:						

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	
ADRESA E PLOTE	
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	
POZITA	
NENSHKRIMI	
DATA	
VULA	

⁵ Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.